

VENDIM
Nr.227, datë 23.4.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI BASHKISË SË QYTETIT TË ERSEKËS TË
MJEDISEVE TË ISH-BRIGADËS SË KËMBËSORISË DHE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT,
TË CILAT JANË NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-brigadës së këmbësorisë dhe të degës së mobilizimit në qytetin e Ersekës, të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojnë në pronësi kësaj bashkie, për t'i përdorur për nevojat e komunitetit, për ngritjen e një shkolle të arsimit profesional, të njësive të shërbimit, për apartamente për të pastrehët dhe për muzeun e ushtrisë.
 2. Pronat me numër rendor 567 dhe 568 të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhen vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
 3. Bashkisë së Ersekës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë së Ersekës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano